



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_, date \_\_\_\_ .01.2026

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT DHE PARASHIKIMIT  
AFATMESËM TË TË ARDHURAVE PËR PBA 2027-2029**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma e), Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat Vendore”, Kreu VII, neni 33-41 si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 138 datë 27.11.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale 2026”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 145 datë 22.12.2025 “Për miratimin e kalendarit për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2027” Kryetari i Bashkisë Kolonjë në mbledhien e Këshillit Bashkiak të dates 27.01.2026

PROPOZOI:

1. Të miratojë raportin e vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave sipas tabelës bashkëlidhur.
  - a. Dy vitet e para vitit buxhetor (2024-2025)
  - b. Vitin Buxhetor 2026 dhe
  - c. Tre vitet e ardhshme 2027-2029
2. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Kolonjë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI  
ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
N/KRYETAR  
PETRO RISTO**

Adresa: Sheshi “Rilindja” 7401, Ersekë, Kolonjë, [www.kolonja.gov.al](http://www.kolonja.gov.al), email: [info@kolonja.gov.al](mailto:info@kolonja.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

Nr S66prot

Ersekë më 22/01/2026

RELACION  
PËR  
PROJEKT-VENDIM

NR \_\_\_\_ DATË. \_\_\_\_ .01.2026

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT DHE PARASHIKIMIT  
AFATMESËM TË TË ARDHURAVE PËR PBA 2027-2029**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma e), Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat Vendore”, Kreu VII, neni 33-41 si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 138 datë 27.11.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale 2026”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 145 datë 22.12.2025 “Për miratimin e kalendarit për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2027” Në zbatim të vendimit të këshillit bashkiak nr 117 dt 15.12.2021 “Për miratimin e kalendarit për programin buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe atë vjetor 2023”, paragrafi II-të, kjo bazuar në ligjin nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54, ligjin nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, drejtoria e të ardhurave po ju paraqet një vlerësim të të ardhurave të veta të Bashkisë Kolonjë për një periudhë 6-vjeçare, për vitet 2024, 2025, 2026, 2027, 2028, 2029. Llogaritja e planit të të ardhurave është mbështetur në llogaritjen e kapacitetit të taksave dhe tarifave, si dhe realizimit në vitet të mëparshme, si dhe forcimit të disiplinës fiskale dhe politikave të përcaktuara për periudhën në vijim duke u mbështetur në aktet ligjore në fuqi. Parashikimi i të ardhurave në periudhën afatmesme reflekton dhe ndryshimet e paketës fiskale për efekt të ndryshimeve ligjore por edhe për efektin e pjesës debitore nga vitet e mëparshme arkëtimi i të cilave ka influencë në realizimin e të ardhurave.

Në punën e Drejtorisë së të Ardhurave do kihet parasysh minimizimi i informalitetit dhe rritja e numrit të tatimpaguesve, veçanërisht atyre familjarë me të cilët kemi hasur më shumë problem.

### **1. Të Ardhurat për vitin 2024**

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024 është bërë bazuar në:

- Realizimin faktik të të ardhurave në dy vitet e kaluara.
- Në të dhënat faktike të familjeve që tarifohen, nr e bizneseve dhe sipërfaqeve faktike.
- Planifikimi i furnizimit të popullatës me dru zjarri nëpërmjet furnizimit nga fusha e druve të bashkisë, në bazë të nr të familjeve ekzistuese që do të përdorin dru të zjarrit.
- Pritet realizimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë si rezultat i legalizimeve të ndërtimeve

ekzistuese dhe monitorimin e ndërtimeve të reja si dhe lidhjen e kontratave të reja në bazë të kërkesave që ka pasur në këtë vit.

- Ndryshimin e tarifave të bashkisë për vitin 2024 e cila ndikon në rritjen e të ardhurave edhe për vitin 2024.

Peshën kryesore në Planifikimin e të Ardhurave për vitin 2024 e zë tarifatat vendore në vlerën 71.25% konkretisht tarifa e druve të zjarrit me 13.2% por për shkak se këtë vit nuk është realizuar fusha e druve për banorët kjo tarifë është realizuar vetëm nga arkëtimet e mbledhura për tarifatat në Njësitë Administrative në vlerën 4.17%, qiratë e antenave me 5.81% dhe tarifa e pastrimit në masën 21.29% tarifa e ndriçimit 15.67%.

Takstat vendore zënë 22.3% të Planifikimi i të ardhurave të Bashkisë Kolonjë konkretisht taksa e pasurisë zë 27.5% e realizuar në masën 19.91%, taksa e tokës zë 28.59%, ndikimi në infrastrukturë zë peshën me 20.12% kjo tarifë e ka tejkaluar këtë planifikim pasi ka pasur pagesa për leje ndërtimi dhe legalizime, regjistrimi i automjeteve në masën 12.18% edhe kjo e ka tejkaluar pasi kjo taksë arkëtohet nga DRSHITR Korçë dhe në bazë të akt-rakordimeve kemi më shumë arkëtime.

Në vitin 2024 u realizua plani në masën 72% krahasuar me vitin 2023 ku u realizuan 81.7% dhe kemi një rënie të realizimit të të ardhurave në masën 5.2% kjo si pasojë e përfundimit dhe mosrinnovimi i disa kontratave me hec-et antenat, arkëtimi i kontratave të qerave të tokës, mosfunksionimi i fushës së druve të zjarrit që do sjellë dhe vitin pasardhës një ulje të të ardhurave për këtë zë si dhe ulja e numrit të bizneseve edhe largimi në masë i popullsisë kanë sjellë një rënie të arkëtimet të detyrimeve.

## **2. Të Ardhurat për vitin 2025**

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 është bazuar në:

- Realizimin faktik të të ardhurave në dy vitet e kaluara.

- Në të dhënat faktike të familjeve që tarifohen, nr e bizneseve dhe sipërfaqeve faktike.

- Planifikimi i furnizimit të popullatës me dru zjarri nëpërmjet furnizimit nga fusha e druve të bashkisë, në bazë të nr të familjeve ekzistuese që do të përdorin dru të zjarrit.

- Pritet realizimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë si rezultat i legalizimeve të ndërtimeve ekzistuese dhe monitorimin e ndërtimeve të reja si dhe lidhjen e kontratave të reja në bazë të kërkesave që ka pasur në këtë vit.

- Ndryshimin e tarifave të bashkisë për vitin 2025 e cila ndikon në rritjen e të ardhurave edhe për vitin 2025.

Peshën kryesore në Planifikimin e të Ardhurave për vitin 2025 e zë tarifatat vendore në vlerën 63% konkretisht tarifa e druve të zjarrit me 24.1% kjo vlerë pasqyron shitjen në fushën e druve dhe arkëtimin e tarifës së druve nga Njësitë Administrative, në vlerën 4.7%, qiratë e antenave, dhe tarifa e pastrimit në masën 15.6% tarifa e ndriçimit 9.8%.

Takstat vendore zënë 23.8% të Planifikimi i të ardhurave të Bashkisë Kolonjë konkretisht taksa e pasurisë zë 21.9% e realizuar në masën 16.57%, taksa e tokës zë 22.59%, ndikimi në infrastrukturë zë peshën me 16.7% kjo tarifë nuk e ka tejkaluar këtë planifikim pasi nuk ka pasur pagesa për leje ndërtimi dhe legalizime, regjistrimi i automjeteve në masën 20.91% edhe kjo e ka tejkaluar pasi kjo taksë arkëtohet nga DRSHITR Korçë dhe në bazë të akt-rakordimeve kemi më shumë arkëtime.

Në vitin 2025 u realizua plani në masën 70.5% krahasuar me vitin 2024 ku u realizuan 72% dhe kemi një rritje të realizimit të të ardhurave në masën 8.6% kjo si pasojë e, arkëtimet i kontratave

të qerave të tokës, mbledhja e debise se heceve dhe bizneseve fizik dhe juridik por përqindja më e ulët e 2025 me 2024 është për faktin se plani është më i madh,por arkëtimi në vitin 2025 është më shumë se viti 2024 me vlerë 94 mijë lekë.

### 3. Vitet 2027-2029

Për vitet 2027-2029 janë planifikuar të ardhura të barabarta me vitin 2026, mendojmë duke punuar më fort në vitet e tjera, duke bërë fushata sensibilizuese në komunitet, duke organizuar grupe pune të përbashkëta me agjensinë pyjore, urbanistikën sektorin e bujqësisë, bordin e kullimit dhe njësitë administrative, duke arkëtuar detyrime të papaguar nga vitet 2011-2025, do të mundohemi të realizojmë planin e vitit 2026 i cili do të jetë bazë edhe për vitet 2027-2029 por në vitet 2026-2029 do të kemi një rritje të parashikimit me një vlerë 70 mijë lekë për arsye sepse janë rritur tarifat në Drejtorinë e pyjores me VKM,tarifat e pastrimit dhe ndriçimit në familjare dhe njësi administrative dhe tarifat e shërbimit

Kjo përbën dhe sfidën për këtë vit që sapo kemi filluar duke qenë që realizimi ka qenë 72% në vitin 2024 në 70.5% në vitin 2025 ,janë arkëtuar më shumë në vitin 2025 me vlerë 94 mijë leke nga viti 2024 por plani është më i madh nga viti 2024.Arsyeja e rritjes së planit janë të ardhurat nga tokat me qera për parqe fotovoltaike,nuk kanë filluar për arketim 3 kontrata pasi nuk u ka dalë leja e ndertimit nga ministria përkatëse.Arsye tjetër:24 % është arkëtuar nga plani vjetor i mbledhjes së shitjes së druve të zjarrit në fushën e druve.

Konceptoi: F.Diko

Pranoi: E.Jogji

Konfirmoi: D.Lifo

Specialis Drejtoria e të Ardhurave

Drejtor Drejtoria e të Ardhurave

Drejtoria D.Ç.J.P.P

**KRYETARI  
ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
N/KRYETAR  
PETRO RISTO**

**PLANI I TËARDHURAVE PËR PBA 2026-2029 I NDRYSHUAR**

Nr	Emertimi	TOTALI					
		2024	2025	2026	2027	2028	2029
<b>A</b>	<b>TAKSA VENDORE</b>	18,883	23,903	23,903	23,903	23,903	23,903
1	Takse Pasurie	5,241	5,241	5,241	5,241	5,241	5,241
1/1	Subjekte Fizik	2,307	2,307	2,307	2,307	2,307	2,307
1/2	Subjekte juridike	685	685	685	685	685	685
1/3	Institucione	132	132	132	132	132	132
1/4	Per ndertesa Banimi	2,117	2,117	2,117	2,117	2,117	2,117
2	Takse mbi Truallin	108	108	108	108	108	108
3	T. vendore, biznesi I vogel	280	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
4	Tak. Regjistrim Automjete	3,800	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
5	Takse Nd. Ne infra. (Nd te reja)	2,300	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
6	Te ardh nga hotele +tarifa per cdo turist	400	400	400	400	400	400
7	Takse e Kalim pronesi	-	-	-	-	-	-
8	Takse per Tabele dhe Reklame	400	700	700	700	700	700
9	Takse Kontrolli Veterinar	4	4	4	4	4	4
10	Tatim mbi te ardhurat personale	900	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000
11	Renta Minerare	50	50	50	50	50	50
12	Taksa mbi token bujqesore	5,400	5,400	5,400	5,400	5,400	5,400
<b>B</b>	<b>TARIFAT VENDORE</b>	60,320	71,362	71,432	71,432	71,432	71,432
1	Tarife Pastrimi	12,848	11,198	11,206	11,206	11,206	11,206
1/1	Subjekete Fizik	3,650	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000
1/2	Subjekte juridike	3,838	3,838	3,838	3,838	3,838	3,838
1/3	Institucione	760	760	760	760	760	760
1/4	Tarife per pastrimin Familjare	4,600	4,600	4,608	4,608	4,608	4,608
2	Tar. Nd. Urban e mirembajtje	9,454	7,000	7,004	7,004	7,004	7,004
2/1	Subjekte Fizik	2,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
2/2	Subjekte juridike	2,500	1,200	1,200	1,200	1,200	1,200
2/3	Institucione	554	400	400	400	400	400
2/4	Tarife per ndricimin Familje	4,400	4,400	4,404	4,404	4,404	4,404
3	Tar.Zenie Hap Publike	505	505	505	505	505	505
4	Tregu	755	755	755	755	755	755
5	Tarife Parkim automjete	280	280	290	290	290	290
6	Tarife regjstrim biznesi	50	50	50	50	50	50
7	Tarife per leje a certificate	160	160	160	160	160	160
8	Tarife Sherb. Administ Gj.civil	1,230	1,230	1,230	1,230	1,230	1,230
9	Tarife kullote + pyjore	2,631	3,000	3,020	3,020	3,020	3,020
10	Tarife dru zjarri	8,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000
11	Ujitje dhe Kullim	300	300	300	300	300	300
12	Tarifë peshkimi	100	100	100	100	100	100
13	Hece	6,626	6,626	6,626	6,626	6,626	6,626
14	Qera Antene	5,561	3,390	3,390	3,390	3,390	3,390
15	Toka me Qera	7,500	5,200	5,200	5,200	5,200	5,200
16	Fond pyjor me qera	100	15,348	15,348	15,348	15,348	15,348
17	Prodhime te dyta pyjore	100	100	100	100	100	100
18	Tarife e perkohshme turizmi						
19	Tarife sherbim per Qytetaret mjete	20	20	48	48	48	48
20	Tarife per mirembajtje Vareza	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000
21	Tarife per Linja Nentokesore Ajrore	100	100	100	100	100	100
22	Takse Prone Private Pyll.kullote	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
<b>C</b>	<b>Gjoha dhe Mosshyerje ne Afat tedetyrim</b>	800	800	800	800	800	800

1	Mosshlyer kamatvonesa	600	600	600	600	600	600
2	Gjoha nga kontrolli dhe inspektimeosshlyerje ne Afat tedetyrimt	200	200	200	200	200	200
	Llojet e dhe niveli e gjobave per kundravjte Administrative	-	-	-	-	-	-
4	Gjobave per ndotje te hapësire publkike ndotje aksutike	-	-	-	-	-	-
5	Gjoha per nderyrje ne infrastrukture rrugore	-	-	-	-	-	-
6	Gjoha per kryerjen e aktivitetet tregetar pa llicense,autorizim etj.	-	-	-	-	-	-
7	Gjoha per demtime dhe nderhyrje ne rrjetin e ndricimit rrugor U.k.z	-	-	-	-	-	-
8	Gjoha per nderhyrje,demtime mne Hapesirat e gjebera dhe fasada	-	-	-	-	-	-
9	Gjoha ne sektorine bujqesie,pyjore dhe bordi l kullimit	-	-	-	-	-	-
10	Gjoha per perdorim te logos se Bashkise	-	-	-	-	-	-
11	Gjoha per demtim te objekteve te rendesis se veçante	-	-	-	-	-	-
12	Gjoha per inspektim veterinar	-	-	-	-	-	-
<b>D</b>	<b>Te ardhura jo tatimore</b>	<b>472</b>	<b>872</b>	<b>872</b>	<b>872</b>	<b>872</b>	<b>872</b>
1	Te ardhura nga dhënia me qera e aseteve te bashkise	72	72	72	72	72	72
2	Te Ardhura nga sekuestrimet dhe zhdemtimet	-	-	-	-	-	-
3	Te Ardhura nga Shitja e mallrave dhe sherbimeve,aseteve te bashkise	-	-	-	-	-	-
4	Te Ardhura nga Çerdhja	400	400	400	400	400	400
5	Te Ardhura nga Kopeshti		400	400	400	400	400
<b>E</b>	<b>Detyrime te pa mbledhura 18 muaj para</b>	<b>4,000</b>	<b>3,000</b>	<b>3,000</b>	<b>3,000</b>	<b>3,000</b>	<b>3,000</b>
<b>F</b>	<b>Shuma (A+B+C+D+E)</b>	<b>84,475</b>	<b>99,937</b>	<b>100,007</b>	<b>100,007</b>	<b>100,007</b>	<b>100,007</b>
<b>G</b>	<b>Te ardhura kultura ,muze,bibliotekë</b>	<b>180</b>	<b>180</b>	<b>180</b>	<b>180</b>	<b>180</b>	<b>180</b>
1	Bibliotekë muze	60	60	60	60	60	60
2	Te Ardhura Kultura	120	120	120	120	120	120
	<b>Shuma totale ( F+G)</b>	<b>84,655</b>	<b>100,117</b>	<b>100,187</b>	<b>100,187</b>	<b>100,187</b>	<b>100,187</b>

Drejtori i të Ardhurave  
Enea Jorgji